| <p>6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të Prokurimit:</p> <p>6.1 zbatimin e kërkesave për mallra dhe shërbime dhe pune të pranuar nga stafi i Ministria;</p> <p>6.2 azhurnimi i listës së kontraktuesve dhe të furnizuesve;</p> <p>6.3 përgatitja e pagesave dhe procedimi në Divizionin për Buxhet dhe Financa;</p> <p>6.4 përgatitja e dokumentacionit dhe procedurave të prokurimit me vlera të vogla në përputhje me ligjin në fuqi.</p> <p>7. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të Prokurimit për mallra dhe shërbime:</p> | <p>6. Dužnosti i odgovornosti službenika za nabavku:</p> <p>6.1 izvršenje zahteva za robu i usluge i rad primljenih od osoblja Ministarstva:</p> <p>6.2 ažuriranje liste ugovarača i dobavljača;</p> <p>6.3 priprema plaćanja i prosleđivanje Diviziji za budžet i finansije;</p> <p>6.4 priprema dokumentacije i procedura za nabavke male vrednosti u skladu sa zakonom na snazi.</p> <p>7. Dužnosti i odgovornosti Službenika za Nabavku robe i usluga:</p> | <p>6. Tasks and responsibilities of the Procurement Officer:</p> <p>6.1 Implementation of requests for goods, services and works submitted by the Ministry staff;</p> <p>6.2 Updates of the contractors and suppliers lists;</p> <p>6.3 Preparation of payment orders and their procession to the Division for Budget and Finance;</p> <p>6.4 Preparation of procurement documentation and procedures for small values, in accordance with the applicable law.</p> <p>7. Tasks and responsibilities of the Procurement Officer for Goods and Services:</p> |



| | | |
|--|---|--|
| <p>7.1 procedon kërkesat për zotim të mjeteve në Divizionin për Buxhet dhe Financa;</p> <p>7.2 procedon pagesat në Divizionin për Buxhet dhe Financa;</p> <p>7.3 përcjellja e shpërndarjes së mallrave dhe shërbimeve në bazë të kontratave dhe marrëveshjeve;</p> <p>7.4 bën porosinë e mallrave për procedura të vogla.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Certifikuesi</p> <p>1. Zyrtari Certifikues, i raporton dhe është nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Përgjithshëm dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:</p> <p>1.1 sigurimin që llogaritë nuk janë paguar përpara dhe që faturat origjinale i janë bashkangjitur dokumentacionit përcjellës;</p> <p>1.2 sigurimin që procedurat prokuruese janë bërë në përputhje me rregullat e</p> | <p>7.1 podnosi zahteve za posvećenost nad sredstvima u Divizija za Budžet i Finansije;</p> <p>7.2 podnosi isplate u kancelariji za finansije;</p> <p>7.3 praćenje isporuke robe i usluga na osnovu ugovora i sporazuma;</p> <p>7.4 vrši narudžbinu robe za male procedure.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Overavač</p> <p>1. Zvanični Overavač izveštava i nalazi se pod nadzorom Generalnog Sekretara i ima sledeće dužnosti i odgovornosti:</p> <p>1.1 osigurati se da računi nisu ranije plaćeni i da su originalni računi dostavljeni pratećoj dokumentaciji;</p> <p>1.2 osigurati se da su procedure nabavke obavljene u skladu sa pravilima Zakona o</p> | <p>7.1 Processes requests for commitment of funds to the Division for Budget and Finance;</p> <p>7.2 Processes payments to the Division for Budget and Finance;</p> <p>7.3 Follow-up of the distribution of goods and services, based on contracts and agreements reached;</p> <p>7.4 Makes orders for goods purchases in small value procedures.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Certifying Officer</p> <p>1. The Certifying Officer, whom reports to and is under the supervision of the Secretary General, has the following tasks and responsibilities:</p> <p>1.1 Ensures that accounts do not remain unpaid and that original invoices are attached to the relevant documents;</p> <p>1.2 Ensures that procurement procedures are undertaken in compliance with the</p> |
|--|---|--|



| | | |
|---|---|--|
| <p>Ligjit për Prokurim Publik;</p> <p>1.3 siguron që pranimet dhe vlerësimet e tenderëve janë në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik;</p> <p>1.4 kontrollojnë të gjitha faturat e paguara kesh, faturat me vlerë minimale, rrjedhjen e procedurës, origjinalitetin, nënshkrimet, fletëkërkesat, si dhe vlefshmërinë e tyre;</p> <p>1.5 vërteton që kërkesat janë korrekte me vlerën;</p> <p>1.6 vërteton që faturat paguhen në emër të projektit për të cilin janë zotuar mjetet;</p> <p>1.7 vërteton origjinalitetin e nënshkrimit të faturave, kontratave, fletëporosive, raportit të pranimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Njësia e Auditimit të Brendshëm</p> <p>1. Njësia e Auditimit të Brendshëm udhëhiqet nga Udhëheqësi i Njesisë, i cili i</p> | <p>Javnoj nabavci;</p> <p>1.3 osigurati da je prijem i procena tendera u skladu sa Zakonom o Javnoj nabavci;</p> <p>1.4 proverava sve račune plaćene u gotovini, račune sa minimalnom vrednošću, redosled postupka, originalnost, potpise, zahteve kao i njihovo važenje;</p> <p>1.5 potvrđuje da se narudžbenice podudraju sa vrednošću;</p> <p>1.6 potvrđuje da se računi plaćaju u ime projekta za koji su posvećena sredstva;</p> <p>1.7 potvrđuje originalnost potpisa računa, ugovora, porudžbenica, izveštaja o prijemu.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Jedinica Unutrašnje Revizije</p> <p>1. Jedinica Unutrašnje Revizije se predvodi od strane Šefa Jedinice koji</p> | <p>provisions of the Law on Public Procurement;</p> <p>1.3 Ensures that admission and evaluation of bids is conducted in compliance with the Law on Public Procurement;</p> <p>1.4 Checks all invoices paid in cash, invoices with minimal values, procedure flows, originality, signatures, requests and their validity;</p> <p>1.5 Verifies that requests correspond with values;</p> <p>1.6 Verifies that invoices are paid as per the project for which means are committed;</p> <p>1.7 Verifies the originality of the signatures in invoices, contracts, purchase orders, and admission reports.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Internal Audit Unit</p> <p>1. Internal Auditing Unit is lead by the Unit Head, whom reports directly to the</p> |
|---|---|--|



| | | |
|---|---|---|
| <p>raporton Sekretarit të Përgjithshëm.</p> | <p>izveštava Generalnom Sekretaru.</p> | <p>Secretary General.</p> |
| <p>2. Funksionet e Njesisë për Auditim të Brendshëm:</p> | <p>2. Funkcije Jedinice Unutrašnje revizije:</p> | <p>2. The Internal Auditing Unit performs the following functions:</p> |
| <p>2.1 siguron se sistemi i kontrollit të brendshëm është funksional;</p> | <p>2.1 osigurava da je sistem unutrašnje kontrole funkcionalan;</p> | <p>2.1 Ensures the functionality of the internal control system;</p> |
| <p>2.2 siguron se burimet publike përdoren në mënyrë efikase dhe publike;</p> | <p>2.2 osigurava da se javni izvori koriste na efikasan i javan način;</p> | <p>2.2 Ensures efficient and public use of public resources;</p> |
| <p>2.3 jep rekomandime për përmirësimin e masave të parapara në nënparagrafin 2.1 dhe 2.2 të këtij neni.</p> | <p>2.3 pruža preporuke za poboljšanje mera predviđenih u pododjeljku 2.1 i 2.2 ovog člana.</p> | <p>2.3 Provides recommendations for the improvement of measures envisaged in sub-paragraph 2.1 and 2.2 of this Article.</p> |
| <p>3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Njesisë për Auditim të Brendshëm:</p> | <p>3. Dužnosti i odgovornosti Šefa Jedinice Unutrašnje Revizije:</p> | <p>3. Tasks and responsibilities of the Head of the Internal Audit Unit are:</p> |
| <p>3.1 hartimi i politikave dhe procedurave për të udhëzuar personelin e auditimit të brendshëm;</p> | <p>3.1 sastavljanje politika i procedura za usmeravanje osoblja unutrašnje revizije;</p> | <p>3.1 Drafting of policies and procedures to guide internal auditing staff;</p> |
| <p>3.2 përpilimi dhe mirëmbajtja e programit për zgjedhjen dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, përfshirë delegimin efektiv;</p> | <p>3.2 sastavljanje i održavanje programa za odabir i razvoj ljudskih resursa Jedinice Unutrašnje Revizije, uključujući i efikasno delegiranje;</p> | <p>3.2 Compilation and maintenance of the program for the selection and development of human resources for the Internal Audit Unit, including efficient delegation;</p> |
| <p>3.3 koordinimi i përpjekjeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm për ta siguruar përfshirjen adekuate të auditimit</p> | <p>3.3 koordinisanje napora unutrašnje i spoljne revizije u osiguravanju adekvatne obuhvaćenosti revizije i smanjenje</p> | <p>3.3 Coordination of internal and external auditing efforts, in order to ensure adequate inclusion of auditing and to</p> |



| | | |
|--|---|--|
| <p>dhe pakësimin e dyfishimit të përpjekjeve të auditimit;</p> <p>3.4 planifikimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm, përcaktimin e burimeve që janë të nevojshme dhe shikimin nëse plani i miratuar i Auditimit të Brendshëm është përmbushur deri në shkallën në të cilën e mundësojnë burimet e personelit;</p> <p>3.5 sigurimin e cilësisë së angazhimeve të auditimit;</p> <p>3.6 përpilimin dhe mirëmbajtjen e programit të sigurisë së cilësisë për vlerësimin e veprimeve të Njesisë për Auditim të Brendshëm.</p> <p>4. Njësia e Auditimit të Brendshëm përbehet nga auditorë, të cilët i përgjigjen Udhëheqësit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.</p> <p>5. Detyrat dhe përgjegjësitë e Auditorit:</p> <p>5.1 është përgjegjës për vlerësimin e procesit të veprimeve kontrolluese në tërë organizatën bazuar në vlerësimin e përshtatshmërisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm;</p> | <p>dvostruki napor revizije;</p> <p>3.4 planiranje aktivnosti unutrašnje revizije, određivanje neophodnih izvora i razmatranje da li je usvojeni plan Unutrašnje Revizije ispunjen sve do stepena kojeg omogućavaju izvori osoblja;</p> <p>3.5 osigurati kvalitet angažovanja revizije;</p> <p>3.6 sastavljanje i održavanje programa sigurnosti kvaliteta za procenu akcija Jedinice Unutrašnje Revizije.</p> <p>4. Jedinica Unutrašnje revizije sačinjen je od revizora koji odgovaraju Šefu Jedinice Unutrašnje revizije.</p> <p>5. Dužnosti i odgovornosti Revizije:</p> <p>5.1 odgovorna za procenu procesa kontrolnih delatnosti u celoj organizaciji na osnovu procene prilagodljivosti sistema unutrašnje kontrole;</p> | <p>avoid doubling of auditing efforts;</p> <p>3.4 Planning of internal audit activities, determination of necessary resources and review of the internal audit plan and its implementation to the level allowed by human resources available;</p> <p>3.5 Ensuring quality of auditing efforts;</p> <p>3.6 Compilation and maintenance of a quality assurance program, to evaluate activities of the Internal Audit Unit.</p> <p>4. Internal Audit Unit comprises of auditors, accountable to the Head of the Internal Audit Unit.</p> <p>5. Auditor's tasks and responsibilities:</p> <p>5.1 Responsible for the evaluation of the control activity process for the entire organization, based on the assessment of suitability of internal control systems;</p> |
|--|---|--|



| | | |
|--|---|--|
| <p>5.2 vlerësimi nëse dizajni i procesit të kontrollit, siç është bërë dhe paraqitur nga menaxhmenti është adekuat;</p> <p>5.3 përcaktimi nëpërmjet testimit dhe procedurave të tjera, nëse procesi në fakt është duke funksionuar në mënyrë efektive dhe efikase, ashtu siç është synuar;</p> <p>5.4 raportimi i rezultateve të punës së kryer të auditimit dhe ofrimi i rekomandimeve aty ku ka nevojë për përmirësimin e procesit të kontrollit.</p> <p>6. Auditorët e Brendshëm duhet t'i zbatojnë dhe respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, doracakun dhe etikën profesionale të përgatitura nga Njësia Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Njësia për të Drejtat e Njeriut</p> <p>1. Funkcionet e Njesisë për të Drejtat e Njeriut:</p> | <p>5.2 proceniti da li je dizajn procesa kontrole adekvatan, kao što je obavljeno i predstavljeno od strane rukovodstva;</p> <p>5.3 određivanje kroz testiranje i druge procedure, ako proces, u stvari, funkcioniše na efikasan i efektivan način, kao što je i namenjeno;</p> <p>5.4 izveštavanje o rezultatima završenog posla revizije i pružanje preporuka tamo gde je neophodno za poboljšanje procesa kontrole.</p> <p>6. Unutrašnji revizori treba da sprovedu i poštuju zakonske i podzakonske akte na snazi, priručnik i profesionalnu etiku pripremljene od strane Centralne jedinice za Harmonizaciju unutrašnje revizije.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Jedinica za Ljudska prava</p> <p>1. Funkcije Jedinice za Ljudska prava:</p> | <p>5.2 Assessment if the adequacy of the design of the control processes presented by the management;</p> <p>5.3 Determination, through testing and other procedures, if the process is in fact functioning effectively and efficiently, as envisaged.</p> <p>5.4 Reporting of the results of conducted audits and provision of recommendations whenever possible, aimed at improving control processes.</p> <p>6. Internal auditors shall implement and respect applicable laws and by-laws, as well as the handbook and professional ethical standards issued by the Central Audit Harmonization Unit.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Human Rights Unit</p> <p>1. Functions of the Human Rights Unit are:</p> |
|--|---|--|



| | | |
|--|---|---|
| <p>1.1 zhvillon politika dhe udhëzime në respektimin e të drejtave të njeriut në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;</p> <p>1.2 bashkëpunon me institucionin e Ombudspersonit, si dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të Ombudspersonit;</p> <p>1.3 vlerëson zbatimin e të drejtave të njeriut në nivelin e ministrisë;</p> <p>1.4 merr pjesë në draftimin e ligjeve, si dhe akteve të tjera nënligjore;</p> <p>1.5 bën promovimin e të drejtave të njeriut;</p> <p>1.6 kujdeset për zbatimin e ligjeve, të cilat aprovohen nga Kuvendi i Kosovës e të cilat janë në kuadër të përgjegjësive dhe kompetencave të ministrisë;</p> <p>1.7 bashkëpunon me strukturat e nivelit komunal dhe OJQ-të në sferën e promovimit, avancimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut;</p> <p>1.8 merr pjesë në punën e grupeve të</p> | <p>1.1 razvija politike i uputstva za poštovanje ljudskih prava u okviru Ministarstva Ekonomskog razvoja;</p> <p>1.2 saraduje sa institucijom Ombudspersona, kao i prati primenu preporuka Ombudspersona;</p> <p>1.3 ocenjuje primenu ljudskih prava na nivou ministarstva;</p> <p>1.4 učestvuje u sastavljanju zakona, kao i drugih podzakonskih akata;</p> <p>1.5 promovise ljudska prava;</p> <p>1.6 vodi računa o sprovođenju zakona koje odobrava Skupština Kosova, koji su u okviru odgovornosti i nadležnosti ministarstva;</p> <p>1.7 saraduje sa opštinskim strukturama i NVO u oblasti promovisanja, unapređenja i zaštite ljudskih prava;</p> <p>1.8 učestvuje u radu različitih</p> | <p>1.1 To develop policies and guidelines for the respect of human rights, within the Ministry of Economic Development;</p> <p>1.2 To cooperate with the Ombudsman Institution, and the monitor the implementation of Ombudsman's recommendations;</p> <p>1.3 To assess the implementation of human rights at the ministry level;</p> <p>1.4 To take part in drafting laws, and other subsidiary legislation;</p> <p>1.5 To promote human rights;</p> <p>1.6 To ensure implementation of the laws adopted by the Assembly of Kosovo, which cover competencies of the Ministry;</p> <p>1.7 To cooperate with other structures at the municipal level and NGOs in the sphere of promotion, advancement and protection of human rights;</p> <p>1.8 To take part in the work of various</p> |
|--|---|---|



| | | |
|--|--|---|
| <p>ndryshme ndërministrore;</p> <p>1.9 këshillon vendimmarrësit në ministri lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut.</p> <p>2. Njësia për të Drejtat e Njeriut udhëheqet nga Koordinatori i Njesisë, i cili i raporton Sekretarit të Përgjithshëm dhe përbëhet nga Zyrtari i lartë për Barazi Gjinore dhe mundësi të barabarta, Zyrtari për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK), Zyrtar i Lartë për të Drejtat e Minoriteteve si dhe Zyrtari për të Drejtat e Minoriteteve.</p> <p>3. Funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për të Drejtat e Njeriut janë të përcaktuara me akt të veçantë nënligjor, të miratuar nga Qeveria.</p> | <p>međuministarskih grupa;</p> <p>1.9 savetuje donosioce odluka u ministarstvu u vezi sa pitanjima ljudskih prava.</p> <p>2. Jedinica za Ljudska Prava se rukovodi od strane Koordinatora Jedinice, koji izveštava Generalnom Sekretaru i sačinjen je od Visokog službenika za Rodnu jednakost i jednake mogućnosti, Službenika za prava osoba sa invaliditetom, Visokog službenika za prava manjinskih zajednica, kao i Službenik za prava manjinskih zajednica.</p> <p>3. Funkcije, obaveze i odgovornosti Jedinice za Ljudska prava su određene posebnim podzakonskim aktom, usvojenim od strane Vlade.</p> | <p>inter-ministerial groups;</p> <p>1.9 To advise decision-makers in the Ministry on human rights issues.</p> <p>2. The Human Rights Unit is headed by the Unit Coordinator, whom reports to the Secretary General, and comprises an Senior Officer for Gender Equality and Equal Opportunities, an Officer for Right of Persons with Disabilities (PWDs), Senior Officer for Minority Rights and an Officer for Minority Rights.</p> <p>3. Functions tasks and responsibilities of the Human Rights Unit are determined with a special by-law adopted by the Government.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 13 Departamentet</p> <p>1. Në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm, funksionojnë këto departamente:</p> <p>1.1 Departamenti i Politikave të</p> | <p style="text-align: center;">Član 13 Departamenti</p> <p>1. U okviru Ministarstva Ekonomskog Razvoja i zavisno od Generalnog Sekretara, funkcionišu sledeći departamenti/odeljenja:</p> <p>1.1 Departament za Politike</p> | <p style="text-align: center;">Article 13 Departments</p> <p>1. The following departments function within the Ministry of Economic Development and under the subordination to the Secretary General:</p> <p>1.1 Department of Economic</p> |



| | | |
|--|--|--|
| <p>Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimin Evropian;</p> <p>1.2 Departamenti i Energjisë dhe Minierave;</p> <p>1.3 Departamenti i Postë-Telekomunikacionit dhe Teknologjisë Informativë;</p> <p>1.4 Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse;</p> <p>1.5 Departamenti Ligjor.</p> | <p>Ekonomskog Razvoja i Evropisku Integraciju;</p> <p>1.2 Departament za Energetiku i Rudarstvo;</p> <p>1.3 Departament za Poštu i Telekomunikacije i Informativne Tehnologije;</p> <p>1.4 Departament za Usluge podrške;</p> <p>1.5 Pravni Departament.</p> | <p>Development Policies and European Integration;</p> <p>1.2 Department of Energy and Mining;</p> <p>1.3 Department of Post-Telecommunications and Information Technologies;</p> <p>1.4 Department of Support Services;</p> <p>1.5 Legal Department.</p> |
| <p style="text-align: center;">Neni 14 Departamenti i Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimin Evropian</p> <p>1. Funkcionet e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimin Evropian:</p> <p>1.1 harton Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2 organizon procesin e konsultimit me grupet e interesit për Strategjinë</p> | <p style="text-align: center;">Član 14 Departament za Politike Ekonomskog Razvoja i Evropisku Integraciju</p> <p>1. Funkcije Departamenta za Politike Ekonomskog Razvoja i Evropisku Integraciju:</p> <p>1.1 sastavlja Nacionalnu strategiju Ekonomskog i socijalnog razvoja Republike Kosovo;</p> <p>1.2 organizuje proces savetovanja sa zainteresovanim grupama za Nacionalnu</p> | <p style="text-align: center;">Article 14 Department of Economic Development Policies and European Integration</p> <p>1. Functions of the Department of Economic Development Policies and European Integration are the following:</p> <p>1.1 Drafts the National Strategy for Economic and Social Development of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2 Organizes the consultation process with interest groups in relation to the</p> |



| | | |
|---|--|--|
| <p>Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social;</p> <p>1.3 udhëzon të gjitha Ministritë dhe Institucionet tjera përgjegjëse, cakton afatet, bashkërendon dhe ndjekë procesin e përgatitjes prej tyre të Strategjive Sektoriale të Zhvillimit;</p> <p>1.4 përcakton detyrat për Ministritë dhe Institucionet e tjera përgjegjëse për hartimin e Strategjive Ndërsektoriale, cakton afatet, bashkërendon dhe ndjekë procesin e përgatitjes së tyre;</p> <p>1.5 nxjerrë udhëzime dhe rregulla për përmbajtjen e Strategjive sektoriale e ndërsektoriale, procedurën e hartimit të tyre dhe rregullat e sigurimit të pjesëmarrjes së grupeve të interesit në këtë proces;</p> <p>1.6 përgatit Strategjitë e Zhvillimit të Sektorit Energjetik, Minerar dhe të Telekomunikimit;</p> <p>1.7 përditëson Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Republikës së Kosovës dhe strategjitë e</p> | <p>Strategjiu Ekonomskog i Socijalnog razvoja;</p> <p>1.3 predvodi sva Ministarstva i druge odgovorne Institucije, određuje rokove, raspoređuje i prati proces njihove pripreme Sektorskih Strategija Razvoja;</p> <p>1.4 postavlja dužnosti za Ministarstva; i druge odgovorne Institucije za sastavljanje Međusektorskih strategija, postavlja rokove, raspoređuje i prati proces njihove pripreme;</p> <p>1.5 izdaje smernice i pravila za sadržaj Sektorskih i međusektorskih Strategija, proceduru njihovog sastavljanja i pravila za osiguravanje učešća zainteresovanih grupa u ovom procesu;</p> <p>1.6 priprema Strategije Razvoja Sektora Energetike, Rudarstva i Telekomunikacije;</p> <p>1.7 ažurira Nacionalnu Strategiju Ekonomskog i Socijalnog razvoja Republike Kosovo i Strategije Razvoja</p> | <p>National Strategy for Economic and Social Development;</p> <p>1.3 Provides instructions for all ministries and other respective institutions, determines timelines, coordinates and follows the process of preparation of their sectorial development strategies;</p> <p>1.4 Determines the tasks for other ministries and institutions responsible for the compilation of cross-sectorial strategies, determines timelines, cooperates and follows the process of their preparation;</p> <p>1.5 Issues instructions and rules on the content of sectorial and cross-sectorial strategies, the procedure for their drafting and rules for ensuring the participation of interest groups in the process;</p> <p>1.6 Prepares Strategies for the Development of the Energy, Mining and Telecommunication sectors;</p> <p>1.7 Updates the National Strategy for Economic and Social Development of the Republic of Kosovo, and</p> |
|---|--|--|



| | | |
|--|---|---|
| <p>Zhvillimit të sektorit Energjetik, Minerar dhe të Telekomunikimit;</p> <p>1.8 përgatit dhe përditëson, në koordinim me Ministrinë dhe Institucionet përkatëse, bazën e të dhënave për zhvillimin ekonomik kombëtar;</p> <p>1.9 përgatit periodikisht dhe publikon analiza makroekonomike dhe të zhvillimit ekonomik kombëtar e sektorial;</p> <p>1.10 monitoron progresin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe publikon Raportet Vjetore të Progresit;</p> <p>1.11 nxjerrë udhëzime dhe rregulla për Ministrinë dhe Institucionet e tjera përgjegjëse për mbajtjen dhe metodologjinë e monitorimit të progresit të zbatimit të Strategjive Sektoriale;</p> <p>1.12 organizon Monitorimin e Strategjive Ndërsektoriale;</p> <p>1.13 informon periodikisht Këshillin e Ministrave mbi progresin e zbatimit të Strategjive;</p> | <p>sektora Energetike, Rudarstva i Telekomunikacija.</p> <p>1.8 priprema i ažurira, u koordinaciji sa odgovarajućim Ministarstvima i Institucijama, bazu podataka za nacionalni ekonomski razvoj;</p> <p>1.9 periodično priprema i objavljuje makroekonomske analize kao i analize nacionalnog i sektorskog ekonomskog razvoja;</p> <p>1.10 prati napredak sprovođenja Nacionalne Strategije Razvoja i objavljuje Godišnje izveštaje o napretku;</p> <p>1.11 izvodi uputstva i pravila za Ministarstva i druge Institucije odgovorne za odvijanje i metodologiju praćenja napretka primene Sektorske Strategije;</p> <p>1.12 organizuje praćenje Međusektorskih Strategija;</p> <p>1.13 periodično informiše Savet Ministara o napretku primene Strategije;</p> | <p>development strategies for the Energy, Mining and Telecommunication sectors;</p> <p>1.8 Prepares and updates the database on the national economic development, in coordination with relevant ministries and institutions;</p> <p>1.9 Prepares and publishes periodic macro-economic and national and sectorial economic development analyses;</p> <p>1.10 Monitors the progress in the implementation of the National Development Strategy and publishes annual progress reports;</p> <p>1.11 Issues instructions and rules for ministries and other relevant institutions on the conduct and methodology of monitoring progress of the implementation of sectorial strategies;</p> <p>1.12 Organizes monitoring of cross-sectorial strategies;</p> <p>1.13 Periodically informs the Council of Ministers on progress in strategy implementation;</p> |
|--|---|---|



| | | |
|---|--|--|
| <p>1.14 bashkëpunon me Ministrinë e Financave për përcaktimin e treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit dhe përparësitë e investimeve publike;</p> <p>1.15 organizon konferenca dhe debate publike me tema të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës dhe me gjerë;</p> <p>1.16 koordinon procesin e integritimit evropian;</p> <p>1.17 koordinon procesin e planifikimit strategjik dhe zhvillimit të politikave;</p> <p>1.18 koordinon asistencën e jashtme;</p> <p>1.19 ndihmon në procesin e hartimit dhe përmirësimit të politikave dhe propozimeve;</p> <p>1.20 ndihmon në zhvillimin e kapaciteteve të ministrisë, në kuadër të inicimit të reformave dhe vlerësimin e ndikimeve të tyre, dhe</p> <p>1.21 ndihmon në përmirësimin e procesit të konsultimeve me palët e</p> | <p>1.14 sarađuje sa Ministarstvom za Finansije u određivanju glavnih pokazatelja budžeta države i prednosti javnih ulaganja;</p> <p>1.15 organizuje konferencije i javne rasprave na teme direktno vezane za ekonomski razvoj u Republici Kosovo i šire;</p> <p>1.16 koordiniše proces evropske integracije;</p> <p>1.17 koordiniše proces strateškog planiranja i izrade politika;</p> <p>1.18 koordiniše spoljnu pomoć;</p> <p>1.19 pruža pomoć u postupku pisanja i unapređnja politika i predloga;</p> <p>1.20 pruža pomoć u razvoju kapaciteta u ministarstvu, u kontekstu iniciranja reformi i ocene njihovog uticaja; i</p> <p>1.21 pruža pomoć u unapređnju procesa konsultacija sa zainteresovanim stranama</p> | <p>1.14 Cooperates with the Ministry of Finance in determining key budget indicators and advantages of public investments;</p> <p>1.15 Organizes conferences and public debates on topics directly related to the economic development of Republic of Kosovo and beyond;</p> <p>1.16 Coordinates the European Integration process;</p> <p>1.17 Coordinates the strategic planning and policy development process;</p> <p>1.18 Coordinates foreign assistance;</p> <p>1.19 Assists in the process of drafting and improving policies and proposals;</p> <p>1.20 Assists in the development of Ministry's capacities, from the viewpoint of initiating reforms and evaluating their impacts; and</p> <p>1.21 Assists in improving the process of stakeholder and public consultations.</p> |
|---|--|--|



| | | |
|--|---|--|
| <p>interesuara dhe publikun.</p> <p>2. Departamenti i Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimit Evropian udhëhiqet nga Udhëheqësi i Departamentit, i cili për punën e tij i raporton Sekretarit të Përgjithshëm.</p> <p>3. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Udhëheqësit të Departamentit për Politika të Zhvillimit Ekonomik dhe Integritimit Evropian:</p> <p>3.1 drejton, koordinon dhe përgjigjet për punën e Departamentit;</p> <p>3.2 është përgjegjës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Republikës së Kosovës në konsultim me Departamentet tjera dhe kabinetin e Ministrit;</p> <p>3.3 organizon procesin e konsultimit me grupet e interesit për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social;</p> <p>3.4 udhëzon të gjitha Ministritë dhe Institucionet tjera përgjegjëse, cakton afatet, bashkërendon dhe ndjekë procesin</p> | <p>i javnošču.</p> <p>2. Departament Politika za Ekonomski Razvoj i Evropsku Integraciju se rukovodi od Šefa Departamenta, koji o svom radu izveštava Generalnom Sekretaru.</p> <p>3. Dužnosti i odgovornosti Šefa Departamenta za Politike Ekonomskog Razvoja i Evropsku Integraciju:</p> <p>3.1 upravlja, koordiniše i odgovoran je za rad Departamenta;</p> <p>3.2 odgovoran je za sastavljanje Nacionalne Strategije za Ekonomski i Socijalni Razvoj Republike Kosovo u savetovanju sa drugim Departamentima i kabinetom Ministra;</p> <p>3.3 organizuje proces savetovanja sa zainteresovanim grupama u vezi sa Nacionalnom Strategijom Ekonomskog i Socijalnog razvoja;</p> <p>3.4 vodi sva Ministarstva i druge odgovorne Institucije, određuje rokove, raspoređuje i prati proces njihove</p> | <p>2. Department of Economic Development Policies and European Integration is headed by the Department Head, whom reports to the Secretary General.</p> <p>3. Tasks and Responsibilities of the Head of the Department for Economic Development Policies and European Integration are the following:</p> <p>3.1 Heads, coordinates and is responsible for the work of the Department;</p> <p>3.2 Is responsible for the compilation of the National Strategy for Economic and Social Development of the Republic of Kosovo, in consultation with other departments and the Minister's Cabinet;</p> <p>3.3 Organizes the process of consulting stakeholders in the National Strategy for Economic and Social Development;</p> <p>3.4 Instructs all ministries and other relevant institutions, determines timelines, coordinates and follows-up the</p> |
|--|---|--|



| | | |
|--|--|---|
| <p>e përgatitjes prej tyre të Strategjive Sektoriale të Zhvillimit dhe Strategjive Ndërsektoriale;</p> <p>3.5 nxjerrë udhëzime dhe rregulla për përmbajtjen e Strategjive Sektoriale, procedurën e hartimit të tyre dhe rregullat e sigurimit të pjesëmarrjes së grupeve të interesit në këtë proces;</p> <p>3.6 përgatit Strategjinë e Zhvillimit të Sektorit Energjetik, Minerar dhe të Telekomunikimit;</p> <p>3.7 përgatit dhe përditëson, në koordinim me Ministrinë dhe Institucionet përkatëse, bazën e të dhënave për zhvillimin ekonomik kombëtar;</p> <p>3.8 përgatit periodikisht dhe publikon analiza makroekonomike dhe të zhvillimit ekonomik kombëtar e sektorial;</p> <p>3.9 monitoron progresin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe publikon Raportet Vjetore të Progresit;</p> <p>3.10 nxjerrë udhëzime dhe rregulla për</p> | <p>pripeme Sektorskih Strategija Razvoja i Medusektorskih Strategija;</p> <p>3.5 izvodi uputstva i pravila za sadržaj Sektorskih Strategija, proceduru njihovog sastavljanja i osiguravanja učešća zainteresovanih grupa u ovom procesu;</p> <p>3.6 priprema Strategiju Razvoja Sektora Energetike, Rudarstva i Telekomunikacija;</p> <p>3.7 priprema i ažurira, u koordinaciji sa Ministarstvima i odgovornim Institucijama, bazu podataka za nacionalni ekonomski razvoj;</p> <p>3.8 periodično priprema i objavljuje makroekonomske analize i analize nacionalnog i sektorskog ekonomskog razvoja;</p> <p>3.9 prati napredak primene Nacionalne Strategije za Razvoj i objavljuje Godišnje izveštaje o napretku;</p> <p>3.10 izvodi uputstva i pravila za</p> | <p>process of the preparation of their sectorial development strategies and of the cross-sectorial strategies;</p> <p>3.5 Issues instructions and rules on the content of sectorial strategies, the procedure for their drafting and rules for ensuring the participation of interest groups in the process;</p> <p>3.6 Prepares Strategies for the Development of the Energy, Mining and Telecommunication sectors;</p> <p>3.7 Prepares and updates the database on the national economic development, in coordination with relevant ministries and institutions;</p> <p>3.8 Prepares and publishes periodic macro-economic and national and sectorial economic development analyses;</p> <p>3.9 Monitors the progress in the implementation of the National Development Strategy and publishes annual progress reports;</p> <p>3.10 Issues instructions and rules for</p> |
|--|--|---|



| | | |
|---|---|---|
| <p>Ministritë dhe Institucionet e tjera përgjegjëse për mbajtjen dhe metodologjinë e monitorimit të progresit të zbatimit të Strategjive Sektoriale;</p> <p>3.11 drejton punën për përditësimin e Strategjive në bazë të të dhënave të zbatimit të tyre dhe të treguesve të zhvillimit kombëtar e sektorial;</p> <p>3.12 informon periodikisht Këshillin e Ministrave mbi progresin e zbatimit të Strategjive;</p> <p>3.13 bashkëpunon me Ministrinë e Financave për përcaktimin e treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit dhe përparësitë e investimeve publike;</p> <p>3.14 organizon konferenca dhe debate publike me tema të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës dhe më gjerë;</p> <p>3.15 ndihmon dhe këshillon në përcaktimin dhe vendosjen e prioriteteve të Ministrisë duke marrë parasysh obligimet që dalin nga procesi i integritimit evropian;</p> | <p>Ministarstva i druge Institucije odgovorne za odvijanje i metodologiju praćenja napretka primene Sektorskih Strategija;</p> <p>3.11 upravlja poslom za ažuriranje Strategija na osnovu podataka njihovog sprovođenja i pokazatelja nacionalnog i sektorskog razvoja;</p> <p>3.12 periodično obaveštava Savet Ministara o napretku primene Strategija;</p> <p>3.13 saraduje sa Ministarstvom za Finansije kako bi odredio glavne pokazatelje državnog budžeta i prednosti javnih ulaganja;</p> <p>3.14 organizuje konferencije i javne rasprave na teme direktno vezane za ekonomski razvoj u Republici Kosovo i šire;</p> <p>3.15 pruža pomoć i daje savete u utvrđivanju i odlučivanju o prioritetima ministarstva imajući u vidu obaveze koje proističu iz procesa Evropske integracije;</p> | <p>ministries and other relevant institutions on the conduct and methodology of monitoring progress of the implementation of sectorial strategies;</p> <p>3.11 Steers the work in updating strategies based on data on their implementation and the national and sectorial development indicators;</p> <p>3.12 Periodically informs the Council of Ministers on progress in strategy implementation;</p> <p>3.13 Cooperates with the Ministry of Finance in determining key budget indicators and advantages of public investments;</p> <p>3.14 Organizes conferences and public debates on topics directly related to the economic development of Republic of Kosovo and beyond;</p> <p>3.15 Assists and advises the determination and stipulation of Ministry's priorities, taking into account the obligations deriving from the European Integration process;</p> |
|---|---|---|



| | | |
|--|--|--|
| <p>3.16 koordinon punën në zhvillimin e dokumenteve kryesore strategjike të cilat hartohen nga strukturat e ministrisë, duke siguruar që këto dokumente të jenë në pajtim me politikën e Qeverisë, si dhe siguron konsistencën mes tyre;</p> <p>3.17 siguron pajtueshmërinë e politikave, planeve dhe strategjive me standardet e BE-së;</p> <p>3.18 kujdeset në krijimin e një sistemi interaktiv në mënyrë që të ketë koordinim mes procesit të zhvillimit të politikave dhe planeve me procesin e planifikimit buxhetor të ministrisë, veçanërisht përmes zhvillimit të deklaratave strategjike buxhetore;</p> <p>3.19 koordinon punën në sigurimin e kontributeve për zhvillimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE-së), Planin Vjetor të Punës dhe siguron harmonizimin e tyre me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe dokumente tjera strategjike;</p> <p>3.20 monitoron zbatimin e PVPE-së dhe Planin Vjetor të Punës dhe raporton tek institucionet relevante, me theks të</p> | <p>3.16 koordinon punën në zhvillimin e dokumenteve kryesore strategjike të cilat hartohen nga strukturat e ministrisë, duke siguruar që këto dokumente të jenë në pajtim me politikën e Qeverisë, si dhe siguron konsistencën mes tyre;</p> <p>3.17 siguron pajtueshmërinë e politikave, planeve dhe strategjive me standardet e BE-së;</p> <p>3.18 kujdeset në krijimin e një sistemi interaktiv në mënyrë që të ketë koordinim mes procesit të zhvillimit të politikave dhe planeve me procesin e planifikimit buxhetor të ministrisë, veçanërisht përmes zhvillimit të deklaratave strategjike buxhetore;</p> <p>3.19 koordinon punën në sigurimin e kontributeve për zhvillimin e Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE-së), Planin Vjetor të Punës dhe siguron harmonizimin e tyre me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe dokumente tjera strategjike;</p> <p>3.20 monitoron zbatimin e PVPE-së dhe Planin Vjetor të Punës dhe raporton tek institucionet relevante, me theks të</p> | <p>3.16 Coordinates the work in the development of key strategic documents drafted by the Ministry's structures, ensuring their compliance and consistency with the Government policies;</p> <p>3.17 Provides the conformity of policies, plans and strategies with EU standards;</p> <p>3.18 Ensures the creation of an interactive system that provides for coordination between the process of policy development plans and the Ministry's budgetary planning, especially through the development of strategic budgetary statements;</p> <p>3.19 Coordinate the work in providing contributions for the development of the European Partnership Action Plan (EPAP), and the Annual Work Plan, and ensures their harmonization with the Mid-Term Expenditure Framework and other strategic documents;</p> <p>3.20 Monitors the implementation of EPAP and Annual Work Plan, and reports to relevant institutions, especially</p> |
|--|--|--|



| | | |
|--|---|--|
| <p>veçantë tek Zyra e Kryeministrit (ZKM) dhe Ministrina e Integrimit Evropian (MIE);</p> <p>3.21 udhëheqë koordinimin e asistencës së IPA-së, dhe asistencës së jashtme bilaterale dhe multilaterale;</p> <p>3.22 siguron që ndihma e jashtme është e ndërlidhur dhe kontribuon në zbatimin e prioriteteve dhe planeve të Qeverisë dhe Ministrisë, si dhe është e ndërlidhur me procesin e planifikimit buxhetor të Ministrisë;</p> <p>3.23 ofron ndihmë për departamente dhe struktura tjera të ministrisë në aspektin e mbështetjes metodologjike për procedurat e përgatitjes dhe menaxhimin e projekteve;</p> <p>3.24 ofron mbështetje Departamentit Ligjor sa i përket përfshirjes së politikave të BE-së në legjislacionin vendor gjatë harmonizimit me <i>Acquis</i>, si dhe kujdeset që legjislacioni që kërkohet nga PVPE-ja të futet në Strategjinë Legjislative të Qeverisë;</p> <p>3.25 bashkëpunon dhe ndihmon zyrën e</p> | <p>naglaskom na Ured Premijera (UP), i Ministarstvom za Evropsku Integraciju (MEI);</p> <p>3.21 upravlja koordinacijom pomoći od IPA, i koordinacijom spoljne bilateralne i multilateralne pomoći;</p> <p>3.22 stara se da spoljna pomoć bude povezana i doprinosi sprovođenju prioriteta i planova Vlade i Ministarstava i da bude u međusobnoj vezi sa procenom planiranja budžeta u ministarstvu;</p> <p>3.23 pruža pomoć službama i drugim strukturama u ministarstvu u smislu metodološke podrške za postupak pripreme i upravljanja projektima;</p> <p>3.24 pruža podršku pravnim službama u smislu uključenja politika EU u domaće zakonske propise u toku njihovog usaglašavanja sa komunitarnim pravom (Acquis) i stara se da zakoni koji se zahtevaju na osnovu APEP budu uvršteni u Zakonodavnu strategiju Vlade;</p> <p>3.25 saraduje i pomaže u radu kancelariji</p> | <p>to the Office of Prime Minister (OPM) and Ministry of European Integration (MEI);</p> <p>3.21 Leads the coordination of IPA assistance, and other foreign bilateral and multilateral assistance;</p> <p>3.22 Ensures that foreign aid is related and contributes to the implementation of governmental and Ministry plans and priorities, and is provided in a manner relevant to the budgetary planning process in the Ministry;</p> <p>3.23 Provides assistance to other departments and structures of the Ministry, from the viewpoint of methodological support in project preparation and management procedures;</p> <p>3.24 Provides assistance to the Legal Department, regarding the inclusion of EU policies in the national legislation, part of the Acquis harmonization process, and ensures the inclusion of legislation requested in EPAP in the Government Legislative Strategy;</p> <p>3.25 Cooperates with and assists the</p> |
|--|---|--|



| | | |
|--|--|---|
| <p>burimeve njerëzore në ministri për ngritjen e kapaciteteve të stafit në çështjen që lidhen me integrimin evropian;</p> <p>3.26 bashkëpunon dhe ndihmon zyrën e komunikimit në ministri për çështjet e komunikimit dhe informimit që kanë të bëjnë me integrimin evropian;</p> <p>3.27 ndihmon monitorimin dhe raportimin e zbatimit të planit zhvillimor institucional të Ministrisë, si dhe aktivitetet tjera për reformimin institucional të Ministrisë;</p> <p>3.28 është përgjegjës për organizimin, udhëheqjen dhe pjesëmarrjen në takimet e rregullta të procesit të Stabilizim Asocimit, takimeve ndërministrorë dhe takimeve me organizatat donatore dhe akterët tjerë relevantë;</p> <p>3.29 kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm.</p> <p>4. Departamenti i Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Integrimin Evropian</p> | <p>za ljudske resurse u ministarstvu na jačanju kapaciteta osoblja u pitanjima koja su povezana sa evropskom integracijom;</p> <p>3.26 saraduje i pomaže kancelariji za komunikaciju u ministarstvu u vezi sa pitanjima komunikacija i informisanja koja imaju veze sa evropskom integracijom;</p> <p>3.27 pomaže u praćenju i podnošenju izveštaja o sprovođenju institucionalnog razvojnog plana ministarstva, kao i drugih aktivnosti na institucionalnoj reformi u ministarstvu;</p> <p>3.28 je odgovoran za organizovanje, vođenje odnosno učešće na redovnim sastancima u okviru procesa stabilizacije i pridruživanja, međuministarskim sastancima i sastancima sa donatorskim organizacijama i drugim važnim činiocima;</p> <p>3.29 obavlja i druge poslove na zahtev Generalnog Sekretara.</p> <p>4. Departament za Politike Ekonomskog Razvoja i Evropskih Integracija sačinjen je</p> | <p>office for human resources of the Ministry in building staff capacities in relation to European integration matters;</p> <p>3.26 Cooperates with and assists the office for communication in the Ministry in matters pertaining to information on European Integration endeavors;</p> <p>3.27 Assists in monitoring and reporting on the implementation of the Ministry's institutional development plan, and in other activities in relation to the Ministry's institutional reform;</p> <p>3.28 Is responsible for the organization, chairmanship and participation in regular meetings of the Stabilization-Association Process, inter-ministerial meetings and meetings with donor organizations and other relevant stakeholders;</p> <p>3.29 Performs other duties, as requested by the Secretary General.</p> <p>4. Department of Economic Development Policies and European Integration</p> |
|--|--|---|



| | | |
|--|--|---|
| <p>përbëhet nga Divizioni i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit, Divizioni i Strategjive Sektoriale, Divizioni i Integritimit Evropian, si dhe Divizioni i Koordinimit të Politikave.</p> <p>5. Funkcionet e Divizionit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit:</p> <p>5.1 harton Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Republikës së Kosovës;</p> <p>5.2 organizon procesin e konsultimit me grupet e interesit për Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social;</p> <p>5.3 përditëson Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Republikës së Kosovës në bazë të rezultateve të zbatimit të saj dhe të treguesve kombëtarë të zhvillimit ekonomik e social;</p> <p>5.4 monitoron progresin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit dhe publikon Raportet Vjetore të Progresit;</p> | <p>od Divizije Nacionalne Strategije Razvoja, Divizije Sektorskih Strategija, Divizije za Evropsko Integriranje, kao i Divizije za Koordiniranje Politika.</p> <p>5. Funkcije Divizije Nacionalne Strategije Razvoja:</p> <p>5.1 sastavlja Nacionalnu Strategiju Ekonomskog i Socijalnog Razvoja Republike Kosovo;</p> <p>5.2 organizuje proces savetovanja sa zainteresovanim grupama za Nacionalne Strategije Ekonomskog i Socijalnog Razvoja;</p> <p>5.3 ažurira Nacionalnu Strategiju Ekonomskog i Socijalnog Razvoja Republike Kosovo na osnovu rezultata njene primene i nacionalnih pokazatelja ekonomskog i socijalnog razvoja;</p> <p>5.4 prati napredak sprovođenja Nacionalnih Strategija Razvoja i objavljuje godišnje izveštaje o napretku;</p> | <p>comprises the Division of the National Development Strategy, Division of Sectorial Strategies, Division of European Integration and Division for Policy Coordination.</p> <p>5. Functions of the Division of the National Development Strategy:</p> <p>5.1 Drafts the National Strategy for Economic and Social Development of the Republic of Kosovo;</p> <p>5.2 Organizes the process of consultations with interest groups on the National Strategy for Economic and Social Development;</p> <p>5.3 Updates the National Strategy for Economic and Social Development of the Republic of Kosovo, based on the results of its implementation and the national economic and social development indicators;</p> <p>5.4 Monitors progress in the implementation of the National Development Strategy and publishes Annual Progress Reports;</p> |
|--|--|---|



| | | |
|---|--|--|
| <p>5.5 bashkëpunon me Ministrinë e Financave për përcaktimin e treguesve kryesorë të buxhetit të shtetit dhe përparësitë e investimeve publike;</p> <p>5.6 organizon konferenca dhe debate publike me tema të lidhura drejtpërdrejt me zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës dhe me gjerë;</p> <p>5.7 përgatitë dhe përditëson, në koordinim me Ministrinë dhe Institucionet përkatëse, bazën e të dhënave për zhvillimin ekonomik kombëtar;</p> <p>5.8 përgatitë periodikisht dhe publikon analiza makroekonomike dhe të zhvillimit ekonomik kombëtar e sektorial.</p> <p>6. Detyrat dhe përgjegjësitë e Udhëheqësit të Divizionit të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit:</p> <p>6.1 drejton punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik e Social të Republikës së Kosovës;</p> | <p>5.5 sarađuje sa Ministarstvom za Financije u određivanju glavnih pokazatelja dr̄zavnog bud̄žeta i prednosti javnih ulaganja;</p> <p>5.6 organizuje konferencije i javne rasprave na teme u vezi sa direktnim ekonomskim razvojem u Republici Kosovo i šire;</p> <p>5.7 priprema i ađurira, u koordinaciji sa Ministarstvima i odgovarajućim Institucijama, bazu podataka za nacionalni ekonomski razvoj;</p> <p>5.8 periodično priprema i objavljuje makroekonomske analize i analize nacionalnog i sektorskog ekonomskog razvoja.</p> <p>6. Dužnosti i odgovornosti Šefa Divizije Nacionalne Strategije za Razvoj;</p> <p>6.1 vr̄ši sastavljanje Nacionalne Strategije Ekonomskog i Socijalnog Razvoja Republike Kosovo;</p> | <p>5.5 Cooperates with the Ministry of Finance in the determination of the main budget indicators and advantages of public investments;</p> <p>5.6 Organizes conferences and public debates on topics directly related to the economic development in the Republic of Kosovo and beyond;</p> <p>5.7 Prepares and updates the database on the national economic development, in coordination with relevant ministries and institutions;</p> <p>5.8 Prepares and publishes periodic macro-economic and national and sectorial economic development analyses.</p> <p>6. Tasks and responsibilities of the Head of the Division for the National Development Strategy:</p> <p>6.1 Steers the work in the compilation of the National Strategy for Economic and Social Development of the Republic of Kosovo;</p> |
|---|--|--|



| | | |
|---|---|---|
